

ABUJLHAN
nr. Pr. 4526
Dt 03/05/2018



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr 23 Datë 12/04/2018

Për

miratimin e kërkesës, për leje përdorimi të burimit ujore të perrenjve Holtes dhe Holmizes dege e lumit Devoll, për prodhim hidroenergjie në bashkia Gramsh Qarku Elbasan nga "DELIU 3D" sh.p.k .

Në mbështetje të ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d, neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 datë 13.05.2015 Keshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posacme, dokumentave shoqerise, afatit të vlefshmerise, formularve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore". Vendimit të Keshillit Kombëtar të Ujit Nr 5 datë 16.02.2016 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Keshillit të Basenit Ujore si dhe Vendimi të Keshillit Kombëtar të Ujit Nr 6 datë 16.02.2016 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencise së Basenit Ujore" Keshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

Miratimin e kërkesës, për leje përdorimi të burimit ujore të perrenjve Holtes dhe Holmizes dege e lumit Devoll, për prodhim hidroenergjie në bashkia Gramsh Qarku Elbasan nga "DELIU 3D" sh.p.k .

HEC SHIROKU

Perrenjte Holtes dhe Holmizes dege e lumit Devoll

Vepra e marrjes Nr 1

X=4446801 Y=4536422 Z=1188 m

Prurja mesatare 0.33 m³/sek.

Prurja llogaritese: 0.47 m³/sek.

Prurja ekologjike: 0.024 m³/sek

Vepra e marrjes Nr 2

X=444167 Y=4535042 Z=1195 m

Prurja mesatare 0.12 m³/sek.

Prurja llogaritese: 0.17 m³/sek.

Prurja ekologjike: 0.007 m³/sek

Godina e centralit

X=4446563 Y=4534426 Z=870 m


Per përdorimin e këtij burimi ujor duhet të plotësohen kushtet e mëposhme:

- Te mos cenohet furnizimin me uje të popullatës dhe të industrisë për nevojat e tanishme dhe të prespektives.
- Te zbatohet grafikun për vaditje në kohë (ditë) dhe në sasi (l/s) për çdo vit të hartuar nga Bordet e Kullimit të pushtetit vendor dhe atë Qendrorë.
- Te respektohet grafikun e vaditjes edhe jashtë periudhës kur e kërkon Bordi i Kullimit.
- Te respektohet rrjedhjen ekologjike.
- Si dhe duke plotësuar kushtet e përcaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet AUB Seman për zbatimin e këtij vendimi.

PËRGJEGJËSI AUB SEMAN

Isuf Myrtaj



KRYETARI I KBUS SEMAN

Baki BALA

